



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers*

### Plotësim dhe ndryshim i Kërkesës për Shprehje Interesi (të datës 30 shtator, 2024)

**Data: Tetor 03, 2024**

**Shteti: Kosovë**

**Projektit ID: P171098**

**Nr. i ref.: SAS.1.1.ICS.011**

**Emri i kredisë së Bankës Botërore: Projekti për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale të Kosovës**

#### **PROJEKTI PËR REFORMËN E SISTEMIT TË NDIHMËS SOCIALE TË KOSOVËS**

**Punësimi i 32 zyrtarëve të mirëqenies sociale në zyrat e pensioneve**

**REF: SAS.1.1.ICS.011**

#### **HISTORIKU**

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës është duke zbatuar një projekt për pilotimin e reformës së ndihmës sociale. Qëllimi i këtij projekti është të mbështesë familjet më të cenueshme në Kosovë, të përmirësojë barazinë dhe të avancojë reformën e përgjithshme të sistemit të mbrojtjes sociale. Pas mbështetjes së Qendrave për Punë Sociale me punonjës socialë, hapi tjetër është rekrutimi i personelit shtesë për zyrat e pensioneve. Kjo do të sigurojë një tranzicion të qetë në proceset dixhitale të përshkruara në projekt, do të sigurojë informacion thelbësor për palët e interesuara në lidhje me pilotimin SAS dhe skemat tjera në kuadër të MFPT-së, do të mbështesë zbatimin e regjistrimit social dhe do të informojë zhvillimin e politikave të ardhshme në lidhje me reformën.

Projekti i Reformës së Asistencës Sociale ka për qëllim që të rrisë mbështetjen për familjet në nevojë dhe të krijojë një regjistër social gjithëpërfshirës që përfshin të gjitha skemat sociale dhe pensionale. Në ndërkohë, deri në implementimin e plotë të regjistrimit social, zyrat e pensioneve në

Kosovë do të kërkojnë zyrtarë shtesë. Këta zyrtarë do të ndihmojnë në proceset aktuale administrative në zyrat e pensioneve dhe gjithashtu do të trajnohen në sistemin e ri.

Në këtë kontekst, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është duke punësuar 32 zyrtarë të mirëqenies sociale për të punuar në komunat e Kosovës.

## **OBJEKTIVI**

Për të dixhitalizuar procesin e aplikimit dhe për të krijuar një regjistër social gjithëpërfshirës të skemave sociale dhe pensionale në vend, zyrat e pensioneve duhet të pajisen me personel të gatshëm të kontribuojnë në këtë proces duke forcuar kapacitetet e zyrave të pensioneve. Për të forcuar kapacitetin e zyrave të pensioneve dhe për të siguruar që ato janë të përgatitura për të shërbyer dhe informuar aktivitetet brenda pilotimit SAS dhe skemave tjera sociale zbatuara nga MFPT, zyrtarët do të angazhohen për të:

- i. Kompletuar detyra relevante administrative;
- ii. Komunikuar dhe përfunduar procedura administrative që ndërlidhen me pensionistët dhe palët e interesuara për t'i informuar ata në lidhje me procedurat aktuale për aplikimin dhe verifikimin në kuadër të skemave të ndryshme sociale dhe pilotimin e SAS.
- iii. Ofruar mbështetje të përgjithshme për zyrat e pensioneve dhe ofruar informata mbi skemat e pensioneve për kompaninë e IT-së përgjegjëse për hartimin e regjistrit social.

## **FUSHËVEPRIMI I PUNËS**

Zyrtarët e caktuar të mirëqenies sociale në zyrat e pensioneve do të:

- i. Kryejnë vizita në terren për familjet që nuk mund të përfundojnë procesin e verifikimit.
- ii. Pranojnë dosje aplikimi dhe verifikimi për skema të ndryshme.
- iii. Arkivojnë rastet në lidhje me pensionet dhe informoni palët e interesuara për vendimet.
- iv. Përgatisin informata në lidhje me funksionimin e skemave të pensioneve për të drejtuar politikatat e ardhshme.
- v. Kryejnë detyra të tjera të nevojshme për mbështetjen e zyrave përkatëse të pensioneve sipas Njesisë Koordinuese të Projektit.

## **KOHËZGJATJA DHE PAGESA**

- i. Kontrata pritët të fillojë në Nëntor 2024 dhe të vazhdojë deri në Nëntor 2025.
- ii. Zyrtarët do të punojnë me kohë të plotë dhe do të paguhën 500 euro bruto (duke përfshirë të gjitha kontributet pensionale dhe taksat).

## KUALIFIKIMET

- i. Diplomë BA në shkencat sociale ose studentë në vitin e fundit të studimeve; ii. Preferohet të ketë notë mesatare mbi 8;
- iii. Preferohet të ketë njohuri të dëshmuara rreth skemave pensionale në Kosovë ose praktikë në departamentet e pensioneve;
- iv. Kërkohej përvojë e mëparshme në punë në terren.

## MARRËDHËNIET DHE DETYRIMET E RAPORTIMIT

Zyrtarët e angazhuar të mirëqenies sociale do të raportojnë drejtorit të zyrave përkatëse të pensioneve, drejtorit të departamentit të pensioneve dhe do t'i japin të gjitha informatat e kërkuara Koordinatorit dhe personave të tjerë përgjegjës në kuadër të projektit pilot të reformës së ndihmës sociale.

Kriteret e vlerësimit janë:

Përshkrimi	Pikët
Kualifikimet e përgjithshme	40 pikë
Përvoja në detyra të ngjashme	60 pikë
	100 pikë

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet tek paragrafi VII, paragrafët, 7.34, 7.35, 7.36 dhe 7.37 të “Rregulloret të Prokurimit për Kredimarrësit IPF” të Bankës Botërore korrik 2016 (“Rregulloret e prokurimit”), që parashtrojnë politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesi. Një Konsulent do të zgjidhet në përputhje me metodën e Konsulentit Individual (KI) në rregullimet e marrëveshjes së mësipërme të përshkruara në Rregulloret e Prokurimit dhe duke ndjekur kriteret e lartpërmendura të vlerësimit.

Informata të mëtejshme mund të merren në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës d.m.th. 08:00 to 16:00.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen në versionin elektronik në adresën e mëposhtme (me email) **deri të hënën, Tetor 14, 2024 deri në orën 16:00, dhe duhet të përfshijnë:**

- CV
- Dëshmia e kualifikimeve (diploma dhe certifikata)
- Letër motivuese – maksimumi një faqe (duke treguar gjithashtu rajonin e preferuar për detyrën)
- Dëshmi i përvojës së punës (referencë, kontratë ose deklaratë besimi)

**Projekti për Reformën e Sistemit të Ndhmës Sociale të Kosovës (SAS)**

**Njësia për Koordinimin e Projektit – NKP**

**Sheshi “Edit Durham” nr.46, Prishtinë**

**Ndertesë e ish Kino Armata,**

**Kati 1, zyra numer 107, 10 000 Pristina, Kosovo**

**E-mail: [procurement.SAS@rks-gov.net](mailto:procurement.SAS@rks-gov.net)**